



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr.70**

**2005**

**26 shtator**

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MF nr.1, datë 7.9.2005	Për kriteret e veçanta të marrjes në punë dhe deklarimin e pasurisë së nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.....	2435
Vendim i GJK nr.21, datë 20.9.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.216, datë 28.4.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	2436
Vendim i GJL nr.1, datë 24.3.2005	Me objekt anulimin e pjesshëm të vendimit të KKK Pronave nr.13, datë 29.10.1993, anulim i kontratës së dhurimit.....	2438
Vendim i ERE-s nr.49, datë 16.9.2005	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	2445
Vendim i ERE-s nr.50, datë 16.9.2005	Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria Juana sh.p.k.....	2446
Vendim i ERE-s nr.51, datë 16.9.2005	Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria Marjakaj sh.p.k.....	2446
Vendim i ERE-s nr.52, datë 16.9.2005	Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria WTS Energji sh.p.k.....	2447
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilo Xheladini.....	2447

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 7.9.2005**

**PËR KRITERET E VEÇANTA TË MARRJES NË PUNË DHE DEKLARIMIN E PASURISË SË NËPUNËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE**

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës pika 4 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.108, datë 11.2.2005 “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave” pika 6, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

1. Përcaktimi i kriterëve të veçanta të punësimit për nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, ka për qëllim të sigurojnë një administratë, të aftë profesionalisht, të pavarur dhe me integritet të lartë moral, nëpërmjet procedurave transparente përzgjedhëse dhe të mbështetura në kriterë tërësisht profesionale, për të përballuar detyrat e përcaktuara me ligj.

2. Nisur nga natyra e punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), si qendër kombëtare e mbledhjes, administrimit, analizës së informacionit financiar, konfidencialitetit të këtij informacioni, identifikimit të zbulimeve dhe shkëmbimit të informacionit me struktura të tjera kompetente të zbatimit të ligjit brenda vendit dhe me homologë e partnerë ndërkombëtarë, personeli i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, krahas kriterëve të përgjithshme të punësimit, të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, do të ketë të specifikuar dhe kriterë të veçanta specifike sipas përcaktimeve të bëra në këtë udhëzim.

Kriteret e veçanta për punonjësit e DPPPP

3. Fitojnë të drejtën për të konkurruar në pozicionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, nëpunësit që krahas kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në ligjin “Statusi i nëpunësit civil”, plotësojnë edhe kriteret e veçanta, të përcaktuara si më poshtë:

a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë (sipas kriterëve dhe përshkrimeve të punës për çdo pozicion).

b) Të kenë integritet të lartë moral.

c) Sipas certifikatës familjare, të mos jenë dhe të mos kenë anëtarë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen veprave penale.

ç) Të mos zhvillojnë aktivitete që janë në konflikt interesi dhe të mos kenë konflikt interesi me subjekte të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, të ndryshuar.

d) Të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore të largimit nga puna ose nga shërbimi civil.

dh) Të pranojnë dhe të deklarojnë menjëherë pas fillimit të punës dhe për çdo vit kalendarik në vazhdim, deklaratën e pasurisë.

e) Të deklarojnë se pranojnë vullnetarisht aplikimin e procedurave të verifikimit ndaj tyre.

f) Të deklarojnë ruajtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” dhe respektimin e kërkesave të ligjit “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”.

g) Të mos jenë anëtarë të ndonjë force ose organizate me karakter etnik dhe nationalist.

4. Kriteret specifike dhe përshkrimi i punës për çdo pozicion sipas strukturës së miratuar me urdhër të Kryeministrit nr.34, datë 16.3.2005 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave” janë ato të përcaktuara nga grupi i punës i ngritur në Drejtorinë e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

5. Për informacion rreth pikave c, ç, d dhe g të nenit 3 të këtij udhëzimi bashkëpunohet me Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, Ministrinë e Rendit Publik, institucionet dhe ose qendrat e punës, të banimit, arsimimit të kandidatëve.

6. Nëpunësit e DPPP-së, që nuk u nënshtrohen kërkesave të ligjit “Për deklarimin e pasurive financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, do të bëjnë deklarimin e pasurisë pranë sektorit të personelit të DPPP-së, menjëherë sapo të fillojnë punë, dhe për çdo vit kalendarik në vazhdim, sipas formatit të përcaktuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

7. Përgjegjësi i sektorit të personelit të DPPP-së, informon të gjithë nëpunësit e DPPP-së për detyrimet që u lindin, lidhur me deklarimin e pasurisë, për respektimin e ligjit “Për rregullat e etikës në administratën publike” (si parimet e përgjithshme të etikës, konflikti i interesave dhe shmangia e tyre, veprimtaria e jashtme e nëpunësit, detyrimet e tjera gjatë dhe pas periudhës së punësimit), detyrimet që lindin nga ligji “Për trajtimin e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror” dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
Arben Malaj

**VENDIM**  
**Nr. 21, datë 20.9.2005**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Pllaçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 22.11.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çëshjen nr.27 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** AGIM SHEHI, përfaqësuar nga avokat Ilir Murati, me prokurë.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.216, datë 28.4.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Pala kërkuese ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimit të mësipërm të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

- Vendimi i kolegjit penal është rezultat i një procesi të parregullt ligjor sepse janë shkelur nenet 31, 33 e 42 të Kushtetutës.

- Gjykimi i çështjes së kërkuesit Agim Shehi, në Gjykatën e Lartë, është bërë pa marrë dijeni kërkuesi dhe mbrojtësi i tij për ditën e gjykimit. Në këtë mënyrë, në këtë gjykim kërkuesi dhe mbrojtësi i tij nuk kanë qenë të pranishëm. Për pasojë, kërkuesit i është mohuar e drejta për t’u dëgjuar dhe e drejta për t’u mbrojtur nga avokati i caktuar prej tij.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoj relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.463, datë 13.5.2003, ka deklaruar fajtor kërkuesin Agim Shehi për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor në bazë të nenit 290/2 të Kodit Penal, dhe e ka dënuar me 5 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.513, datë 3.10.2003, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e ndryshuar atë vetëm lidhur me vuajtjen e dënimit me burgim, të cilin, në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal ia jep me kusht për 4 vjet, duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.216, datë 28.04.2004, ka vendosur: Prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë në pjesën ku urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të gjykuarin Agim Shehi dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi ka pretenduar se nuk i është dhënë mundësia të marrë pjesë vetë dhe nuk është mbrojtur me avokat në gjykimin në Gjykatën e Lartë pasi nuk ka marrë kopjen e rekursit të prokurorit, si dhe nuk ka marrë dijeni për ditën e gjykimit.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata Kushtetuese konkludon se kërkesa e paraqitur është e bazuar.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese ripërsërit se garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhet të respektohen edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Natyrisht, mënyra me të cilën aplikohen këto garanci në gjykimin në këtë Gjykatë, duhet të varet nga karakteristikat e veçanta të procesit në këtë instancë, në mbajtjen parasysh të tërësisë së procesit (pra në të tri shkallët) dhe në rolin e Gjykatës së Lartë në këtë proces.

Respektimi i parimit të barazisë së armëve, si dhe ai i mbrojtjes me avokat janë aspekte të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Për pasojë, në funksion të respektimit të këtyre parimeve një rol të veçantë luajnë edhe njoftimi i palës, si dhe i avokatit mbrojtës të tij si për kopjen e rekursit, ashtu edhe për ditën e gjykimit.

Nga materialet e dosjes rezulton se kopja e rekursit të prokurorit nuk i është dorëzuar kërkuesit, por avokatit që kërkuesi kishte caktuar për mbrojtjen e tij në shkallë të parë dhe në apel. Është e vërtetë se ky avokat, mbi deklarin në seancë të kërkuesit, është caktuar të realizojë mbrojtjen e tij në dy shkallët e para të gjykimit. Mirëpo nga procesverbali i seancave gjyqësore si në shkallë të parë, ashtu edhe në apel, nuk rezulton që këtij avokati t'i jenë dhënë tagra mbrojtjeje tej këtyre dy shkallëve të gjykimit. Në këto rrethana dhe në mungesë të ndonjë prokure noteriale me të cilën do të ngarkohej avokati i mësipërm me mbrojtjen e kërkuesit në gjykimin në Gjykatën e Lartë, ai nuk mund të ushtrojë funksionin e mbrojtësit në këtë Gjykatë. Për pasojë, dorëzimi i kopjes së rekursit këtij avokati e bën njoftimin e këtij akti të pavlefshëm. Kjo situatë e ka bërë të pamundur marrjen dijeni të kërkuesit për ditën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, sepse marrja dijeni për rekursin është sinjali i parë që merr pala që i kundrejtohet ky akt, kohë nga e cila ky i fundit fillon të ndjekë listën e datave të gjykimit në këtë Gjykatë. Mirëpo, në kundërshtim me këtë, Gjykata e Lartë duke u mjaftuar me shpalljen e ditës së gjykimit në listën e gjyqeve, e ka shqyrtuar çështjen në mungesë të kërkuesit dhe në mungesë të mbrojtësit, duke shkelur kështu parimin e barazisë së armëve.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky parim luan një rol të rëndësishëm në procesin penal, sepse në këtë rast, përballë personit të akuzuar për veprën penale, është shteti.<sup>1</sup> Për këtë arsye shteti (në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë) duhet të ndërmarrë të gjitha masat ligjore që t'i sigurojë të akuzuarit mundësitë e njohjes dhe të deklarinimit për ... vlerësimet ligjore të çështjes.<sup>2</sup> Në rastin në shqyrtim, kjo Gjykatë ka pasur në dispozicion pretendimet ligjore të prokurorit për mosaplikimin e

1. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr..19, datë 12.6.2003 në çështjen me kërkues Gj. Bardhaj

2. Po aty

kushtit në rastin e dënimit me burgim të kërkuesit, por nuk i ka dhënë mundësi këtij të fundit që të njihet dhe të komentojë lidhur me këto pretendime. Në këtë drejtim, Gjykata Lartë duhet të mbante parasysh edhe faktin se pranimi i recursit mund të çonte, ashtu siç ka ndodhur në fakt, në keqësimin e pozitës së kërkuesit, pa i dhënë mundësi këtij të mbrohet, ndërkohë që pala e akuzës jo vetëm që ka paraqitur recursin, por edhe është përfaqësuar nga prokurori në gjykimin në këtë Gjykatë.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese vlerëson se Gjykata e Lartë nuk duhet të zhvillonte gjykimin në mungesë të kërkuesit, por duhet ta shtynte seancën për t'i dhënë mundësi atij të vinte në dijeni për recursin dhe për realizimin e mbrojtjes.

Në këto kushte, Gjykata e Lartë, në drejtimet e mësipërme, ka shkelur standardet për një proces të rregullt ligjor dhe për pasojë, kërkesa e paraqitur duhet të pranohet.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.216, datë 28.4.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### VENDIM

**Nr. 1, datë 24.3.2005**

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Zamir Poda	Anëtar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Vladimir Bineri	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Vladimir Metani	Anëtar
Shpresa Beçaj	Anëtare
Irma Bala	Anëtare
Besnik Imeraj	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Agron Lamaj	Anëtar
Ylvi Myrtja	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Evgjeni Sinoimeri	Anëtare

në seancën gjyqësore të datës 24.3.2005, shqyrtuan çështjen civile me palë:

PADITËS: VIRGJIL LLAKMANI, KRISTAQ LLAKMANI, ERMIRA LLAKMANI.  
TË PADITUR: OLLGA ÇOMO, DHIMITRAQ ÇOMO, përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka e Flora Gjini.  
KKKP pranë Bashkisë Pogradec.  
OBJEKTI: Anulim i pjesshëm i vendimit të KKK Pronave nr.13, datë 29.10.1993, anulim i kontratës së dhurimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.1802, datë 17.11.2000, ka vendosur rrëzimin e padisë.

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.349, datë 15.11.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kundër vendimeve të mësipërme kanë ushtruar rekurs paditësit që kërkojnë ndryshimin e tyre dhe pranimin e padisë, duke parashtuar:

- Vendimet janë rrjedhojë e proceseve të parregullta ligjore, pasi nuk është zhvilluar drejt debatit gjyqësor.

- Në vendimet e gjykatave nuk gjejnë vend pretendimet tona dhe nuk arsyetohet përse nuk merren parasysh duke mos bërë analizën e plotë të provave dhe ballafaqimit të tyre me kërkesat ligjore.

- Të dyja vendimet janë rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve dhe akteve nënligjore të dala për zbatimin e tij.

- Banesa është marrë nga shteti në kohën që e kishte në pronësi trashëgimlënësi Gjokë Vako, duke i dhënë në këmbim të saj një ndërtesë njëkatëshe me dy dhoma të mëdha, dy të vogla e bodrume ish-pronë e familjes Erebara. Akti i Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec që ka miratuar këmbimin nuk përbën akt shpronësimi.

- I padituri, KKK Pronave, në mënyrë të kundërligjshme, ia ka kthyer banesën e përbërë nga 16 dhoma e anekset përkatëse të paditurës Ollga Çomo, duke njohur vetëm atë pronare dhe jo trashëgimtarët ligjorë të njohur me dëshminë e kërkuar nga vetë e paditura.

- Kontrata e dhurimit lidhur midis të paditurve është e pavlefshme pasi na mohon bashkëpronësinë.

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 11.5.2004, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara.

#### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Kristaq Ngjela e Artan Hoxha, përfaqësuesit e të paditurve, avokatët Fatmir Braka e Flora Gjini, që kërkuan lënien në fuqi të vendimeve, e si analizuan në tërësi çështjen,

#### VËREJNË:

Me vendimin nr.13, datë 29.10.1993, Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve pranë bashkisë Pogradec, ka vendosur që të njohë pronare të ligjshme Ollga Çomon (Vako) për një ndërtesë dykatëshe, me oborr, me 16 dhoma, dy korridore, dy banjo, të ndodhur në lagjen nr.1, rruga "Reshit Çollaku" në qytetin e Pogradecit me një sipërfaqe prej 312, 60 m<sup>2</sup> me kufizimet përkatëse. Në bazë të nenit 13/2 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, pronarja duhet të paguajë 51 719 lekë, që përbën vlerën e shtesave të bëra nga shteti në atë ndërtesë, pas pagimit të së cilës banesa i kalon në pronësi.

Vendimi i mësipërm, marrë mbi kërkesën e të paditurës Ollga Çomo, KKK Pronave e bazon mbi një testament që ka bërë trashëgimlënësi (babai i saj) Gjokë Vako, sipas të cilit pas vdekjes të gjithë banesën ia lë në pronësi Ollga Çomos, banesë kjo njëkatëshe, me dy dhoma të mëdha, dy të vogla e oborr.

Rezultoni nga aktet që ndodhen në dosje dhe pranohet nga gjykatat se Gjokë Vako ka pasur në pronësi një shtëpi dykatëshe me 16 dhoma, oborr e anekset përkatëse. Me propozim të seksionit të shëndetësisë së Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec, është marrë nga ky Komitet vendimi nr.14, datë 22.2.1952, në të cilin thuhet se pronari Gjokë Vako, me vullnetin e tij të lirë, është dakord të shkëmbejë pa shpërblim lokalit e tij me atë që është sot materniteti, duke përcaktuar edhe përbërjen e dy ndërtesave e kufizimet e tyre. Pas kësaj, Gjokë Vako e familja kanë pasur në pronësi e kanë përdorur për banim banesën e përbërë nga një kat.

Më 23.11.1972, Gjokë Vako ka bërë para noterit një testament në të cilin shprehet se në shenjë mirënjohjeje, respekti e dashurie ndaj vajzës Ollga Gjokë Tira, për afeksionin e interesimin e vazhdueshëm që ka treguar ndaj tij, me vullnetin e lirë e të plotë, pas vdekjes së tij, i lë në pronësi "një shtëpi banimi që e kam në pronësi e posedim, të ndodhur në lagjen nr.3 Pogradec në rruga "Reshit Çollaku", me kufizime: në lindje Niko Ballkameni, në jug Kolë Maxhari, në veri liqeni dhe rrugën publike, e përbërë nga një kat, me bodrume poshtë, me dy dhoma të mëdha e dy të vogla dhe me oborr para e mbrapa, me kusht që në të të banojë djali i saj, nipi im i quajtur Koço Tira."

Në testament, trashëgimlënësi shprehet edhe se "me rastin e bërjes së këtij testamenti, unë përjashtoj si trashëgimtarë time ligjore mbi këtë shtëpi vajzën time, Vika Gjokë Llakmani".

Sikurse u përmend, ndodhemi para një veprimi juridik të shkëmbimit të ndërtesave dhe testamentit të lënë nga Gjokë Vako, me të cilin i linte në pronësi të paditurës Ollga Çomo banesën ku ata efektivisht banonin.

E paditura Ollga Çomo, me vdekjen e trashëgimlënësit Gjokë Vako më 22.2.1974, ka kërkuar të bëhet dëshmia e trashëgimisë dhe me aktin material nr.51, datë 29.6.1993, duke u përshkruar se kishte vdekur Gjokë Vako, se ai kishte bërë testament ku shprehte dëshirën e vullnetin e tij, që pas vdekjes i linte në pronësi të plotë vajzës Ollga Çomo shtëpinë njëkatëshe me dy dhoma të vogla, dy dhoma të mëdha e oborr, njihet trashëgimtarë testamentare vetëm e paditura Ollga Çomo, ndërsa trashëgimtarë ligjorë për çdo lloj pasurie ishin Ollga Çomo, Ermira, Virgjil, Kristaq, Roza e Vasil Llakmani.

Më 9.9.1999, paditësit Kristaq, Virgjil dhe Ermira Llakmani, me cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit Gjokë Vako, kanë ngritur padi kundër KKK Pronave dhe personit të tretë Ollga Çomo, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të KKK Pronave, deklarimin e pavlefshëm të kontratës së dhurimit lidhur midis të paditurve Ollga Çomo e Dhimitraq Çomo, njohjen si bashkëpronarë në banesën e kthyer Ollga Çomos dhe pjesëtimin e pasurisë, që përbëhej nga shtëpia me 16 dhoma e anekse, me pretendimin se me testamentin e Gjokë Vako së paditurës Ollga nuk i ishte lënë në pronësi ajo shtëpi, por shtëpia njëkatëshe me dy dhoma, që efektivisht kishte në pronësi në kohën e bërjes së testamentit.

Gjykata e Rrethit Korçë, me vendimin e saj, ka rrëzuar kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetimin se trashëgimlënësi Gjokë Vako, me testamentin e datës 23.11.1972, ka disponuar në favor të Ollga Çomos shtëpinë e banimit që iu dha në shkëmbim të shtëpisë objekt gjykimi, sepse banesa e lënë në testament ka qenë pronë e ish-pronarit Ali Erebara të cilit i ishte shpronësuar në vitin 1950. Paditësit, arsyetohet në vendimin e gjykatës, pretendojnë se Gjokë Vako i ka lënë në pronësi me testament vajzës së tij, së paditurës Ollga Çomo, një banesë të individualizuar dhe, në këto kushte, për banesën objekt gjykimi duhet të zbatohet trashëgimia ligjore. Por, vazhdon arsyetimin gjykata, ish-pronarit Gjokë Vako i njihet pronësia mbi banesën objekt gjykimi dhe ka vend që vullneti i testatorit t'i shtrijë efektet mbi këtë banesë pasi, sipas përcaktimeve të tij, trashëgimia me ligj ka vend kur trashëgimlënësi nuk e ka disponuar me testament pasurinë dhe për pasojë dhe kontrata e dhurimit objekt gjykimi është e ligjshme e nuk ka vend të anulohet pasi e paditura Ollga, duke qenë pronare e vetme e banesës, ka disponuar me vullnetin e saj të lirë në favor të djalit të saj.

Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, duke pranuar faktet si më sipër se e paditura Ollga Çomo kishte banuar realisht në shtëpinë e lënë me testament në pronësi të saj, derisa me vendim të KKK Pronave, iu kthye ish-pronarit Ali Erebara se, në zbatim të ligjit, shteti, nëpërmjet të KKK Pronave, ka ndërhyrë duke prishur në mënyrë të njëanshme kontratën e shkëmbimit, me qëllim që të rregullonte një padrejtësi që i ishte bërë ish-pronarit Ali Erebara dhe se me zgjidhjen e kësaj kontrate shkëmbimi, KKK Pronave ka rivendosur në gjendjen e mëparshme

trashëgimtare testamentare, të paditurën Ollga Çomo duke i kthyer asaj në pronësi shtëpinë e të tatit. Gjithashtu, shprehet gjykata e apelit, trashëgimlënësi me testament ka shprehur vullnetin e tij duke kaluar pronësinë në favor të Ollgës, duke përjashtuar vajzën tjetër dhe se nuk ka bazë për trashëgimi ligjore se vullneti i tij ka qenë i qartë, të përjashtojë nga trashëgimia vajzën, Vika Llakmani. Më tej, pranohet në vendimin e gjykatës së apelit, nuk qëndron pretendimi i paditësve lidhur me faktin se në testament nuk bëhet fjalë për objektin në gjykim, pasi është realizuar qëllimi i ligjvënësit që prona të shkojë tek ish-pronari.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjejnë të pabazuar vendimet e gjykatave, konstatojnë se ka interpretime joligjore e jo të njëjta në lidhje me testamentin, gëzimin e të drejtave që rrjedhin prej tij sipas vullnetit të testatorit dhe trashëgimisë ligjore dhe për pasojë çmojnë se është e nevojshme të unifikohet praktika gjyqësore në këto drejtime.

Trashëgimia është një nga format e fitimit të pronësisë që, si institut juridik, shërben për të mbrojtur e respektuar të drejtat pasurore që gëzon çdo person i cili është i lirë ta disponojë atë sipas dëshirës, duke pasur parasysh që ky disponim mos vijë në kundërshtim me interesat e personave të tjerë. Kjo trashëgimi shprehet në atë ligjore dhe testamentare.

Në bazë të nenit 372 të Kodit Civil, "testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anën e të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes". Forma, efektet, rrethi i trashëgimtarëve, çelja e trashëgimisë, përjashtimet nga trashëgimia, pavlefshmëria e testamentit e problemet e tjera që lidhen me trashëgiminë me testament parashikohen në një sërë dispozitash, por, nisur nga problemet që kanë dalë nga shqyrtimi i çështjes me palë Virxhil Llakmani etj., e të paditurve Ollga Çomo e KKK Pronave, do të trajtohen çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me trashëgiminë testamentare si një institut i rëndësishëm juridik, që shërben për të respektuar të drejtat pasurore të shtetasve.

Nga tërësia e dispozitave ligjore mbi pronësinë e trashëgiminë del qartë se çdo person që ka zotësi të plotë juridike për të vepruar, është i lirë të disponojë pasurinë e tij sipas dëshirës, me kusht që ky disponim mos cenohet interesat e personave të tjerë. Kjo liri e disponimit të pasurisë nënkupton mundësinë që, pas vdekjes së disponuesit, të kalojë në ata persona që ai dëshiron e mbi këtë bazë janë përcaktuar kriteret e trashëgimisë ligjore dhe testamentare. Trashëgimia ligjore është trashëgimia e trashëgimtarëve të ligjshëm, e cila vepron në mungesë të testamentit nga trashëgimlënësi.

Çdo person, me vullnet të lirë, ka të drejtë që, me testament, të përcaktojë se kujt do t'i kalojë pasuria mbas vdekjes së tij dhe me vdekjen disa të drejta e detyrime të tij shuhen, disa i transferohen trashëgimtarëve siç janë të drejtat pasurore ose pronësia.

Në kuptimin e tij, testamenti është një akt juridik personal, i njëanshëm, me të cilin testatori deklaron vullnetin individual për kalimin e pronësisë të trashëgimtarët dhe që prodhon efekte nga momenti i vdekjes së testatorit që përbën edhe kohën e çeljes së trashëgimisë. Në përjashtim nga rregullat e përgjithshme të fitimit të të drejtave pasurore ose të pronësisë, në trashëgiminë testamentare ato kalojnë te personi ose personat që ka përcaktuar trashëgimlënësi me testament. Në qoftë se ka testament, kemi të bëjmë me një trashëgimi të domosdoshme, e drejtë kjo që mund të ushtrohet brenda kuotës së disponueshme të përcaktuar nga trashëgimlënësi dhe trashëgimtari përfiton, *ipso jure* trashëgiminë pa qenë e nevojshme kryerja e ndonjë veprimi.

Testamenti, përveç shfaqjes së vullnetit të lirë të testatorit, përmban edhe këto disponime të rëndësishme:

a) Në caktimin e një personi apo të disa personave si trashëgimtarë duhet që të tregohet edhe pasuria e trashëgimlënësit që lihet në trashëgim që përbën edhe përmbajtjen kryesore të testamentit.

b) Të caktohet trashëgimtari apo trashëgimtarët që do t'u kalojë pronësia dhe pjesa që do të trashëgojë secili.

Në rastin e caktimit të trashëgimtarit, trashëgimlënësi, në disponimet pasurore që formojnë përmbajtjen e testamentit, mund t'i lërë atij të gjithë pasurinë që ka dhe që kemi të bëjmë me trashëgimtar universal të cilit i shkojnë të gjitha të mirat materiale të trashëgimlënësit apo mund t'i lërë objekte ose të mira materiale të përcaktuara dhe që kemi të bëjmë me trashëgimtar me titull të veçantë i cili është personi që, si pasojë e testamentit, i takojnë të drejta pronësie mbi një ose disa sende të caktuara.

c) Njëkohësisht, trashëgimlënësi me testament mund t'i heqë të drejtën e trashëgimit ndonjërit prej trashëgimtarëve apo disave prej tyre (përjashtimi nga trashëgimia, neni 377 i Kodit Civil).

Duke iu referuar dispozitave ligjore dhe problemeve që kanë dalë në praktikën gjyqësore e në unifikim të saj, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë pranojnë se trashëgimtarit do t'i kalojë posedimi vetëm mbi atë pasuri trashëgimore që posedonte trashëgimlënësi deri në momentet e fundit të jetës së tij ose të përcaktuar në testament (pasuri që efektivisht ekzistonte) dhe jo mbi atë pasuri që për arsye të ndryshme nuk e posedonte trashëgimlënësi.

Në çështjen në shqyrtim ndodhemi para trashëgimisë testamentare të trashëgimlënësit Gjokë Vako, i cili, duke shprehur vullnetin e tij të lirë, i linte vajzës së vet, të paditurës Ollga Çomo, në pronësi shtëpinë që posedonte dhe shprehet në testament se përjashtonte si trashëgimtarin e tij vajzën tjetër, Vika Gjokë Llakmani mbi këtë shtëpi. Del qartë se vullneti i testatorit konkretizon lënien dhe përjashtimin nga trashëgimia për atë shtëpi që ai kishte në posedim që nga viti 1952, pra ndodhemi para përcaktimit konkret të sendit, që përbën disponimin e testatorit dhe të personit që trashëgon e përjashtohet nga trashëgimia mbi atë shtëpi, pra përjashtimi i vajzës Vika Llakmani është pjesor mbi këtë shtëpi, e jo mbi çdo pasuri. Arsyetimet që bëhen në vendimin e gjykatës së rrethit dhe asaj të apelit se në zbatim të testamentit të lënë nga Gjokë Vako me të drejtë është njohur pronare për banesën objekt gjykimi e paditura Ollga Çomo me vendim të KKK Pronave, se vullneti i trashëgimlënësit i shprehur në testament për të kaluar shtëpinë në pronësi të së paditurës dhe përjashtimi nga trashëgimia e vajzës tjetër, se nuk qëndron pretendimi i të paditurve se nuk është disponuar mbi sendin për të cilin shprehet testamentlënësi, janë të pabazuara. Siç u theksua më lart, trashëgimlënësi ka përcaktuar banesën që posedonte me përbërje e kufij të qartë dhe jo banesën që kishte shkëmbyer në vitin 1952. Nuk është i pranueshëm arsyetimi se, meqë shtëpia e disponuar me testament nuk ekziston, pasi iu kthye ish-pronarit, për të realizuar vullnetin e testatorit, trashëgimtares Ollga Çomo duhet t'i kalojë në pronësi shtëpia tjetër. Kjo jo vetëm për faktin se në trashëgiminë testamentare është përcaktuar rigorozisht shtëpia, por edhe se në kohën e bërjes së testamentit, trashëgimlënësi Gjokë Vako, nuk e posedonte shtëpinë tjetër, ajo ishte në pronësi të shtetit e i kthyer në institucion mjekësor. Nuk ndodhemi përpara një testamentari universal që të fitonte çdo pasuri të trashëgimlënësit, por para faktit që vullneti i trashëgimlënësit ka ndryshuar për shkak të ndryshimeve ligjore e për pasojë ndryshojnë edhe marrëdhëniet e krijuara duke iu përshtatur regjimit të ri juridik me ndërhyrjen e ligjit të veçantë "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Testamenti edhe në rastin në shqyrtim ka shprehjen e vullnetit të lirë të trashëgimlënësit për një objekt të caktuar e në asnjë rast nuk mund të merret si hipotetik. Ai do të pranohet ashtu siç është e s'mund të zëvendësohet pasuria e caktuar në të me një pasuri tjetër.

Në kushtet e krijuara, kur shtëpia e lënë me testament iu kthye ish-pronarit, ky testament, nuk ka më objekt e mbetet pa efekte, pasi disponimi i testatorit ka qenë për atë shtëpi. Përjashtimi i njëres nga vajzat nga e drejta e trashëgimisë është vetëm për atë shtëpi, pra ndodhemi para përjashtimit pjesor e jo mbi çdo pasuri. Në këto rrethana, kur kjo pronë nuk ekziston më në pronësi të trashëgimlënësit, nuk mund të diskutohet për efekte të trashëgimisë testamentare, por për trashëgiminë ligjore të trashëgimtarëve të Gjokë Vacos.

Pretendimi i paditësve për anulimin e pjesshëm të vendimit nr.13, datë 29.10.1993 të KKK Pronave në mënyrë të gabuar gjykatat nuk e trajtojnë si të drejtë. Në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, ka detyrë të shqyrtojë kërkesat e ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre ligjorë dhe në përfundim kur i gjen të bazuara, i njeh pronën ish-pronarit dhe ia kthen atij (nëse është gjallë) apo trashëgimtarëve ligjorë (kur ish-pronari ka vdekur).

Me vendimin e përmendur KKK Pronave pranë bashkisë Pogradec, ka njohur pronare Ollga Çomon dhe kthimin e objektit asaj me arsyetimin se ajo kërkonte të kthehej në shtëpinë e saj, e cila i ishte marrë me vendimin nr.14, datë 22.2.1952 të Komitetit Ekzekutiv të K.P të Rrethit Pogradec. Në mënyrën si ka vepruar KKK Pronave është futur në problemet e marrëdhënieve të trashëgimisë mbi pronën, i ka njohur pronësinë të paditurës Ollga Çomo mbi atë pronë me arsyetimin se është trashëgimtare testamentare duke vepruar në kundërshtim me përmbushjen e rregullt e ligjore të

detyrës së tij gjë që e bën vendimin e cenueshëm. Komisioni, nëse do të realizonte trashëgiminë testamentare, nuk mund t'i njihte pronësinë e të kthente objektin të paditurës Ollga Çomo mbi një objekt tjetër, të ndryshëm nga ai që është shprehur testatori dhe, për të cilën nuk është bërë kërkesë para tij.

Me padinë e ngritur, paditësit kanë kërkuar edhe konstatimin e pavlefshëm të kontratës së dhurimit nr.596 rep e nr.315 kol, datë 6.9.1994 lidhur ndërmjet të paditurve Ollga Çomo e Dhimitraq Çomo. Rezulton nga kjo kontratë dhurimi se Ollga Çomo, si pronare e shtëpisë me 16 dhoma, i dhuron 7 dhoma Dhimitraq Çomos, dhuratë që ky e ka pranuar. Duke pretenduar se banesa duhet t'i nënshtrohet trashëgimisë ligjore, paditësit kërkojnë konstatimin e pavlefshëm, kërkesë që gjykata e rrethit e ka rrëzuar me arsyetimin se ajo është e ligjshme, pasi e paditura Ollga Çomo duke qenë pronare e ligjshme e banesës, ka disponuar me vullnetin e saj të lirë në favor të djalit. Gjykata e apelit ka lënë në fuqi në tërësi vendimin e gjykatës së rrethit pa analizuar pjesën që bën fjalë për kontratën e dhurimit.

Edhe në këtë pjesë vendimet e gjykatave duhet të ndryshohen për shkak të pranimit të padisë për kthimin e banesës trashëgimtarëve ligjorë e duke mos pranuar si pronare të vetme të paditurën Ollga Çomo.

### PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485/d të Kodit të Procedurës Civile,

### VENDOSËN:

Ndryshimin e vendimit nr.1802, datë 17.11.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe të vendimit nr.349, datë 15.11.2002 të Gjykatës së Apelit Korçë si më poshtë:

Ndryshimin e vendimit nr.13, datë 29.10.1993 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve pranë bashkisë Pogradec duke njohur pronësinë e ish-pronarit Gjokë Vako, për një banesë dykatëshe me 16 dhoma, me oborr, 2 banjo, 2 korridore me sipërfaqe totale 312,6 m<sup>2</sup> kufizuar nga veriu-liqen, lindja-vëllezërit Vesho, perëndim-Nastasi Gusho, jugu-rrugë dhe kthimin e saj trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Gjokë Vako.

Konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit nr.596 rep, nr.315 kol, datë 6.9.1994 lidhur ndërmjet të paditurve Ollga Çomo e Dhimitraq Çomo dhe gjithë disponimeve të bëra më vonë.

Ky vendim për njehsimin e praktikës gjyqësore dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

### MENDIMI I PAKICËS

Pakica është e mendimit se vendimi nr.349, datë 15.11.2002 i Gjykatës së Apelit Korçë, është rrjedhojë e zbatimit dhe e respektimit të kërkesave ligjore. Për pasojë në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 485/a të Kodit të Procedurës Civile, ai duhet të lihet në fuqi.

Është vërtetuar se i quajturi Gjokë Vako ka pasur në pronësi një godinë banimi të ndodhur në qytetin e Pogradecit, të përbërë nga dy kate në lagjen nr.1, rruga "Reshit Çollaku", me sipërfaqe prej 312,60 m<sup>2</sup>.

Kjo banesë, me vendimin nr.14, datë 22.2.1952 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit dhe me pëlqimin e pronarit të saj, është shkëmbyer me godinën e ish-maternitetit të qytetit të Pogradecit, meqenëse kjo e fundit nuk kishte kapacitet dhe nuk plotësonte kërkesat për qëllimin që përdorej.

Godina në fjalë, ish-pronë e të quajturit Ali Erebara, ishte konfiskuar në favor të shtetit në vitin 1950.

Me aktin testamentar, datë 23 nëntor 1972, i quajturi Gjokë Vako disponon në favor të njëjës prej vajzave të tij e konkretisht të paditurës Ollga Çomo, banesën (ish-martenitetin) që kishte

në pronësi të tij, duke përjashtuar vajzën tjetër, nënën e palës paditëse. Që nga kjo kohë dhe më pas në këtë godinë ka banuar djali i Ollga Çomos, i padituri Dhimitraq Çomo.

Më pas, me miratimin e ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve", trashëgimtarët e Ali Erebarës kanë kërkuar pranë Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave, njohjen në pronësinë dhe kthimin e banesës së konfiskuar në vitin 1950, e cila sikundër u përmend më lart, ishte këmbëyer me banesën e Gjakë Vakos.

Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave vendosi të njohë dhe ta kthejë këtë pronë në favor të tyre. Ndërkohë edhe e paditura Ollga Çomo, në cilësinë e trashëgimtares testamentare të Gjakë Vakos, i drejtohet Komisionit në fjalë dhe kërkon njohjen e kthimin e ish-pronës së babait të saj, e cila sikundër u tha ishte shkëmbyer në vitin 1952 me atë të Ali Erebarës.

Me vendimin nr.13, datë 29.10.1993 të KKK të Pronave pranë bashkisë Pogradec vendoset njohja e kthimi i kësaj prone në favor të Ollga Çomos. Më tej e paditura Ollga Çomo me kontratën e datës 6.9.1994 këtë pronë ia ka dhuruar djalit të saj Dhimitraq Çomo.

Pala paditëse, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të Gjakë Vakos, nga vajza tjetër e tij, kanë kërkuar me padi anulimin e vendimit të cituar të KKK të Pronave, si dhe anulimin e kontratës së sipërpërmendur të dhurimit. Paditësit duke vënë në dyshim testamentin dhe mënyrën e përpilimit të tij, kanë pretenduar se në të bëhet fjalë për godinën, e cila i është kthyer trashëgimtarëve të Ali Erebarës dhe jo për godinën, njohur dhe kthyer me vendim të KKK të Pronave në favor të Ollga Çomos.

Në të kundërt, të paditurit kanë pretenduar se akti testamentar është vullneti i ligjshëm i trashëgimtarëve Gjakë Vako dhe është përpiluar në bazë e për zbatim të ligjit. Po ashtu, ata pretendojnë se me të drejtë KKK të Pronave, ka disponuar në favor të trashëgimtarëve të Ali Erebarës për pronën e tyre të konfiskuar në vitin 1950 dhe në favor të Ollga Çomos për pronën e babait të saj të këmbëyer në vitin 1952.

Pakica çmon se vendimet e të dyja gjykatave janë rrjedhojë e vlerësimit të drejtë, objektiv dhe ligjor të të gjitha rrethanave të çështjes.

Në rastin konkret me të drejtë arsyetohet në vendimet e të dyja gjykatave se vullneti i testatorit Gjakë Vako ka qenë për disponimin e një pjese të pasurisë së tij dhe konkretisht të banesës që ai ka pasur në pronësi, për kohën pas vdekjes në favor të Ollga Çomos. Në momentin e kryerjes së këtij veprimi juridik të njëanshëm, trashëgimtarët Gjakë Vako ka shprehur vullnetin e tij të lirë për të disponuar në favor të njëres prej vajzave, **shtëpinë e vetme që ai kishte në pronësi**. Me fjalë të tjera, ai ka disponuar për një send të përcaktuar nga e gjithë pasuria e tij, send i cili ishte i vetëm për nga natyra e tij.

Fakti që më pas kjo banesë, si rrjedhojë e kërkesave të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 i është kthyer familjes Erebara dhe palës së paditurit i është kthyer banesa e mëparshme, nuk do të thotë se në këtë rast kemi të bëjmë me një send, pronësia e të cilit në momentin e përpilimit të aktit testamentar nuk ishte fituar nga trashëgimtarët. Pretendimi i palës paditëse se testamenti nuk mund t'i shtrijë efektet edhe mbi sende të cilat janë fituar nga testatori pas hartimit të testamentit, pavarësisht se në parim është i drejtë, porë në raport me rastin konkret nuk qëndron dhe nuk mund të qëndrojë. Efektivisht kemi të bëjmë me të njëjtin send në vështrimin juridiko-civil dhe "dallimi" i sforcuar formal që kërkon apo më saktë pretendon pala paditëse se duhet të bëhet, nisur nga karakteristikat fizike të sendit, çmohet se është i gabuar. Sikundër u tha edhe më lart, testatori ka pasur në pronësi një banesë dhe vetëm një dhe këtë banesë ai me vullnet të lirë e ka disponuar në favor të njëres prej vajzave të tij. Trashëgimtarët testamentar këtë send e ka pasur në pronësi në momentin e përpilimit të aktit testamentar dhe rregullimi që ligji i përmendur bëri për kthimin e pronave te pronarët e tyre, më saktë kalimin e banesave në fjalë te këta pronarë, nuk do të thotë se në vështrimin juridiko-civil kemi të bëjmë me një send tjetër të fituar në pronësi. Pra ky send është i përcaktuar në mënyrë individuale nga testamenti dhe nuk mund kurrsesi të trajtohet si pasuri e trashëgimtarëve në tërësi apo si një shtim i pasurisë pas hartimit të testamentit.

Efektivisht kemi të bëjmë me të njëjtin send në pronësi.

Si konkluzion, pakica është e mendimit se trajtimi i kësaj çështjeje ligjore është e nevojshme të bëhet nga një këndvështrim realist, që mban në fokus pasojat e ardhura nga ndryshimi i regjimit juridik të pronës private gjatë periudhës së shtetit totalitar. Rregullimi i mundshëm i këtyre pasojave

në periudhën postkomuniste lidhet me një proces të rregullt ligjor, që garanton respektimin e shprehjes së vullnetit të testatorit në kushtet e krijuara të asaj kohe.

Kështu, ajo që nuk ndryshon nga trajtimi teorik që i bën shumica aspekteve ligjore të kësaj çështjeje dhe që ka rëndësi vendimtare për zgjidhjen e saj është përgjigjja e pyetjes: "Cili ka qenë vullneti i testatorit në kohën e lënies së testamentit?" Shprehje e këtij vullneti është lënia e të vetmes shtëpi banimi për të jetuar dhe disponuar njëherë prej vajzave të tij. Kjo nënkupton se vetëm vajza e tij, si trashëgimtare me titull të posaçëm, përfiton sendin e lënë me testament, shtëpinë e banimit të vetme që kishte testatori dhe jo gjë tjetër.

Kuptimi i kësaj shprehjeje vullneti nga testatori nuk mund të ndryshojë me çeljen e trashëgimisë, pasi është i lidhur me të njëjtin destinacion të sendit dhe plotëson atë qëllim dhe vullnet që kishte ai në kohën e lëshimit të testamentit.

Kështu, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ndryshimin në thelb të pasurisë trashëgimore të konstatuar në kohën e çeljes së trashëgimisë.

Në analizë sa sipër, pakica është e mendimit se vendimi nr.13, datë 29.10.1993 i KKK të Pronave është nxjerrë në përputhje me kërkesat ligjore. Për rrjedhojë edhe kontrata e dhurimit e datës 6.9.1994 në favor të të paditurit Dhimitraq Çomo, është një veprim juridik tërësisht ligjor.

Përsa i përket shkaqeve të parashtruara në rekursin e paraqitur nga pala paditëse, mendimi i pakicës çmon se ato nuk qëndrojnë dhe nuk janë të tilla që të motivojnë apo përlligjin cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë.

Për sa sipër pakica në mbështetje të kërkesave të nenit 485/a të Kodit të Procedurës Civile, është për lënien në fuqi të vendimit nr.349, datë 15.11.2002 të Gjykatës së Apelit Korçë.

Anëtarë: Zamir Poda, Ylvi Myrtja, Besnik Imeraj, Perikli Zaharia, Spiro Spiro, Vladimir Metani

## **VENDIM**

**Nr. 49, datë 16.9.2005**

### **PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.59, datë 29.12.2004 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", pika 9.2, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.9.2005, pasi shqyrtoi aplikimin për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria "OST" sh.a. për vitin 2006,

#### **VENDOSI :**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria "OST" sh.a. për vitin 2006.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**VENDIM**  
**Nr. 50, datë 16.9.2005**

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS SË PARAQITUR NGA  
SHOQËRIA JUANA SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A dhe neni 22, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.9.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Juana sh.p.k., për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike,

**VENDOSI :**

1. Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria Juana sh.p.k. për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, pasi kërkesa nuk është bërë në përputhje me nenin 22 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve të njoftojë shoqërinë Juana sh.p.k. dhe ta informojë atë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**VENDIM**  
**Nr. 51, datë 16.9.2005**

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS SË PARAQITUR NGA  
SHOQËRIA MARJAKAJ SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A dhe neni 22, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.9.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Marjakaj sh.p.k., për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike,

**VENDOSI :**

1. Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria Marjakaj sh.p.k. për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, pasi kërkesa nuk është bërë në përputhje me nenin 22 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve të njoftojë shoqërinë Marjakaj sh.p.k. dhe ta informojë atë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**VENDIM**  
**Nr. 52, datë 16.9.2005**

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS SË PARAQITUR NGA  
SHOQËRIA WTS ENERGJI SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A dhe neni 22, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.9.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria WTS Energji sh.p.k., për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike,

**VENDOSI :**

1. Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria WTS Energji sh.p.k. për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, pasi kërkesa nuk është bërë në përputhje me nenin 22 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.
2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve të njoftojë shoqërinë WTS Energji sh.p.k. dhe ta informojë atë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**KËRKESE**

Shtetësja Miranda Xheladini e datëlindjes 14.6.1964, banuese në lagjen “Çlirim”, Berat, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilo Xheladini i datëlindjes 11.2.1954, lindur në Berat në lagjen “Çlirim”.

**KËRKUESE**  
**Miranda Xheladini**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".  
Tel: 042 555 63; 267 468

**Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:**

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**BOTIMET:**

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

**DOLI NGA SHTYPI:**

**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004**  
**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004**

Doli nga shtypi më 26.9.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë